

VENDIM
Nr.339, datë 31.5.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshillit i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Rreshti i parafundit i shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 246 “-format 520x115 mm figura III 4a/1.” zëvendësohet me:

“-format 520x112mm figura III 4a/1”.

2. Tabela që paraqitet “Figura III 4a/1, neni 248”, zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




fig. III 4 a/1, neni 248

TARGAT E MJETEVE BUXHETORE A PRIVATE, FORMAT A

Permasat jepen ne millimetra

Emblema e flamurit Kombetar, shkronjat, numrat dhe bordura jane ne relief